REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË
SEKTORI I NDIHMËS EKONOMIKE

Kavajë, më 14.01.2026

PROJEKT-VENDIM

Nr.1 datë 14.01.2026

"PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE APLIKUESE QË PËRFITOJNË NGA PROGRAMI I BLLOK-NDIHMËS EKONOMIKE DERI NË 6 PËRQIND NGA FONDI I KUSHTËZUAR DHE NGA BUXHETI I BASHKISË KAVAJË, PËR MUAJIN Dhjetor 2025"

Në mbështetje të Ligjit 139, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", I ndryshuar; Ligjit 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", I ndryshuar ; Ligjit nr.84/2022, datë 24.11.2022 "Për buxhetin e vitit 2023"; Ligjit 57/2019 "Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë"; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" indryshuar; Vendimit te Këshillit Bashkiak nr.59, dt.16.12.2025 "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Kavajë per vitin 2026", konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Tiranë me shkresen nr.1752/prot, dt.24.12.2025, Vendimit te Këshillit Bashkiak nr.2 dt.24.01.2025 "Për miratimin e kritereve për dhënien e ndihmës ekonomike për familjet aplikuese, që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, si dhe për ato, që do të trajtohen me fondet e buxhetit vendor", si dhe referuar relacionit permbledhës, Drejtoria e Shërbimit Social me propozim të kryetarit të Bashkisë, i paraqet Këshillit Bashkiak:

TË VENDOSI:

1.Miratimin e listës përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% nga fondi i kushtëzuar për ndihmën ekonomike përmuajin **Dhjetor 2025**, sipas listës bashkëlidhur, **Nr. Familjeve 4, fondi 17.049 lekë.**

2.Miratimin e listës së familjeve përfituese nga programi i bllok-ndihmës ekonomike deri në 6% nga buxheti i Bashkisë Kavajë, për muajin **Dhjetor 2025**, sipas listës bashkëlidhur, **Nr.familjeve 100, fondi 364.651 lekë.**

2. Efektet financiare të këtij vendimi, do të mbulohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale për 6% e sistemit, dhe nga buxheti Bashkisë Kavajë , llogaria "Transfertë në buxhetet familjare".

3.Ngarkohen Drejtoria e Burimeve Ekonomike, Drejtoria e Shërbimit Social,Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe PAK dhe Njësitë Administrative të Bashkisë Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.
4.Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015,

Drejtore e burimeve ekonomike
Albi LUSHKA

Drejtor i Shërbimit Social
Xhulja UZUNI

Drejtoria e burimeve ligjore
Helidon PLAKU

Sekretari i Këshillit Bashkiak
Meri BITURKU

KRYETARI
Fisnik QOSJA

Sekretar, Ligji Hatemi
Adriana Malo

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAVAJË